REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot 3625 Më 08.10.2026
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

Raporti i punës

Janar – Shtator 2026

DATË /A:	**07.10.2026**
PËR/ZA/TO :	**z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit**
NGA/OD/FROM:	**z.Altin Zhuniqi, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm**
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Raport i punës për periudhën Janar-Shtator 2026**

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka zhvilluar aktivitete në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, menaxhimit të pronës komunale, mbështetjes së bizneseve, realizimit të projekteve zhvillimore dhe promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit. Aktivitetet kryesore gjatë kësaj periudhe janë:

- Gjatë nëntëmujorit të parë të këtij viti, prioritet i veçantë i është kushtuar inkasimit të borxheve të mbetura nga vitet paraprake, në sektorin e taksave afariste dhe qirasë. Gjatë kësaj periudhe janë bërë dërgesat e aktvendimeve për bizneset të cilat ngarkohen me taksë afariste sipas rregullores përkatëse komunale.
- Është përfunduar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Taksa Komunale, me qëllim të përmirësimit dhe përshtatjes së saj me nevojat aktuale.
- Gjatë periudhës nëntëmujore është realizuar **shitja e të gjitha aseteve komunale jashtë përdorimit**, përfshirë edhe automjetet e dala jashtë përdorimit. Me përfundimin e këtij procesi, aktualisht nuk ka stoqe të aseteve jashtë përdorimit, duke përmbyllur një proces të rëndësishëm të menaxhimit të këtyre aseteve.
- Për herë të parë, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka sjellë në Kuvendin Komunal raportin e Komisionit për vlerësimin e kontratave të shfrytëzimit të pronës komunale, duke paraqitur gjendjen e secilës kontratë/lokal dhe rekomandimet konkrete për trajtimin e tyre të mëtejmë.
- Gjatë kësaj periudhe është punuar intensivisht në hartimin e **Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2030**, proces në të cilin Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka rol udhëheqës. Dokumenti është në fazën përfundimtare të hartimit dhe gjatë muajit tetor pritet të dalë në dëgjim publik, para procedimit për miratim.
- Është vazhduar bashkëpunimi me bizneset lokale, Shoqatën "Enologjia" dhe Shoqatën e Afaristëve në Rahovec, përmes vizitave dhe takimeve ku janë diskutuar të arriturat, sfidat e bizneseve dhe mundësitë për avancimin e bashkëpunimit me institucionet publike. Në muajin

shkurt është mbështetur pjesëmarrja e pesë bizneseve lokale nga sektori i prodhimit të tekstilit në një nga panairet më të mëdha të këtij sektori në Evropë, të mbajtur në Stamboll, Turqi.

- Në muajin gusht është organizuar Forumi Ekonomik B2B me Diasporën, në bashkëpunim me Forumin Anadrinia – FARDI, me pjesëmarrjen e rreth **50 bizneseve**. Forumi ka shërbyer për krijimin e kontakteve ndërmjet bizneseve vendore dhe diasporës, prezantimin e potencialit ekonomik të Rahovecit dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim dhe investime.
- Drejtoria ka marrë pjesë në punëtori dhe aktivitete të organizuara nga Caritas Kosova dhe organizata të tjera, me fokus të veçantë në angazhimin e diasporës në zhvillimin ekonomik lokal. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, Komuna e Rahovecit është ftuar që gjatë muajit nëntor të marrë pjesë në një aktivitet në **Vjenë, Austri**, ku do të prezantohen potencialet dhe mundësitë për investime në Komunën e Rahovecit.
- Janë zhvilluar takime dhe komunikime të vazhdueshme me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe KIESA-n lidhur me Parkun Industrial në Opterushë, me qëllim të shtyrjes përpara të procedurave dhe krijimit të kushteve për funksionalizimin e tij.
- Është vazhduar me monitorimin e projekteve kapitale dhe komunikimin me ministritë e linjës për projektet që realizohen në bashkëfinancim. Drejtoria gjithashtu është kujdesur për mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes dhe është bërë finalizimi i Zyrës së Turizmit në Stacionin e Autobusëve.
- Projekti **"Revitalizimi i hapësirave agroturistike dhe trajtimi i peizazhit rural"**, i realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR), ka hyrë në fazën e implementimit. Projekti përfshin ndriçim publik, krijimin dhe rregullimin e hapësirave të gjelbra, hapësira rekreative, shtigje dhe elemente të tjera të infrastrukturës në funksion të zhvillimit të agroturizmit. Punimet janë duke u zhvilluar dhe përfundimi i projektit pritet deri në fund të vitit 2026.
- Kanë vazhduar punimet në projektin "Kroi i Demirit" në Drenoc, si një nga projektet në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe promovimit të potencialit turistik të zonës.
- Gjatë kësaj periudhe është intensifikuar puna për promovimin e Rahovecit si destinacion turistik, me fokus të veçantë në turizmin e verës, agroturizmin, vreshtarinë, trashëgiminë dhe produktet vendore. Në këtë drejtim është vazhduar bashkëpunimi me institucionet qendrore, organizatat, bizneset, kantinat dhe akterët e tjerë të sektorit të turizmit.
- Në kuadër të **Festivalit të Vjeljes së Rrushit – Hardh Fest 2026**, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka dhënë kontributin e saj në organizim, përfshirë verifikimin e dëshmive lidhur me obligimet në taksat komunale për operatorët pjesëmarrës. Me propozim të Drejtorisë është implementuar edhe QR Code për paraqitjen e ankesave dhe vërejtjeve gjatë festivalit. Gjithashtu, Drejtoria ka propozuar që në edicionet e ardhshme festivali të ketë fokus edhe më të madh në promovimin e verës, kantinave dhe prodhuesve vendorë, përfshirë propozimin që të mos lejohet shitja e birrës gjatë festivalit, duke ruajtur dhe fuqizuar identitetin e tij si Festë e Vjeljes së Rrushit.
- Gjatë muajve korrik dhe gusht, në kuadër të **Muajit të Mërgatës**, Drejtoria ka organizuar mbrëmje muzikore në qytet në bashkëpunim me lokalet dhe bizneset vendore. Aktivitetet kanë pasur pjesëmarrje dhe mbarëvajtje të mirë, duke kontribuar në gjallërimin e qytetit gjatë sezonit veror dhe njëkohësisht në mbështetjen e gastronomisë dhe ekonomisë lokale.
- Komuna e Rahovecit ka qenë nikoqire e rreth 200 studentëve nga 40 vende të ndryshme të botës, të cilët gjatë qëndrimit të tyre janë njohur me potencialin turistik dhe ekonomik të komunës. Studentët kanë vizituar kantinat e verës, lokalet agroturistike dhe vreshtat, duke u njohur nga afër me traditën e kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës. Vizita ka qenë një

mundësi e mirë për promovimin ndërkombëtar të Rahovecit si destinacion i turizmit të verës dhe agroturizmit.

- Në kuadër të projektit **GROW**, në bashkëpunim me **Swisscontact**, është duke u punuar në hartimin e **Katalogut Kombëtar të Prodhuesve të Verës**. Në këtë proces Rahoveci përfaqësohet nga **tetë prodhues të verës**, duke siguruar një përfaqësim të rëndësishëm të komunës në promovimin e industrisë së verës në nivel kombëtar.

- Gjatë kësaj periudhe, DEZHT ka përgatitur disa pika drejtuar Kuvendit Komunal në Rahovec:

- Propozimi për dhënie në shfrytëzim të lokalit të Parkut të Qytetit;
- Propozimi për dhënien në shfrytëzim të lokalit 30 m² në rrugën "Avdullah Bugari";
- Propozimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, përmes shprehjes së interesit, të pronës komunale "Hotel Park Plaza";
- Propozimi për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa Komunale;
- Propozimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste në Palestrën Sportive "Mizahir Isma" – Rahovec;
- Raporti i Komisionit për vlerësimin e kontratave të shfrytëzimit të pronës komunale.

Sektori për Ekonomi:

Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2026, janë përgatitur dhe shpërndarë aktvendimet për bizneset të cilat, sipas kodeve ekonomike, ngarkohen me taksë afariste. Gjithashtu, janë dërguar vërejtje për bizneset me obligime të papaguara, me qëllim të rritjes së inkasimit dhe zvogëlimit të borxheve të mbetura nga vitet paraprake. Si rezultat i angazhimit në këtë drejtim, të hyrat gjatë nëntëmujorit të vitit 2026 kanë shënuar rritje prej 107% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë komunale:

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	Rritja ne %
1	Të hyrat në taksë komunale Janar – Shtator	€ 46.387.00	€ 96.101.50	107.17%

Sektori për Zhvillim;

Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2026 është mbajtur në mënyrë të rregullt evidenca e të hyrave dhe ngarkesave nga qiraja e lokaleve afariste dhe pronave të paluajtshme komunale. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm aktualisht menaxhon gjithsej 42 kontrata për shfrytëzimin e pronës komunale, duke përcjellë në vazhdimësi realizimin e obligimeve që dalin nga këto kontrata. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar pëlqimet e punës sipas kërkesave të pranuara, ndërsa për bizneset dhe shfrytëzuesit që kanë pasur vonesa në pagesën e qirasë janë dërguar me kohë vërejtjet për përmbushjen e obligimeve, në përputhje me dispozitat e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20

Të hyrat nga qiratë;

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	Rritja ne %
1	Të hyrat nga qiratë, Janar- Shtator	€ 48.386.50	€ 84,961.69	75.59 %

Zyra e QKRB-së:

Raporti është hartuar bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës së Drejtorisë. Gjatë kësaj periudhe është mbajtur dhe përditësuar në mënyrë të rregullt evidenca e bizneseve në Komunën e Rahovecit, bazuar në të dhënat e sistemit online të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), duke përcjellë regjistrimin dhe ndryshimet e bizneseve që operojnë në komunë.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhen Janar- Shtator 2026:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	156
2	Informata të Bizneseve	62
3	Shuarje të biznesit	12
4	Lëndë të anuluara	0
5	Çerteikata duplikat	6
6	Historiat Biznesi	0
7	Ndryshime në biznes	61
8	Vërtetime indviduale	10
10	Vërtetim individual	02
	Gjithsej lëndë të përfunduara	**309**

Menaxhimi i Asteteve komunale

Menaxhimi i Asteteve komunale

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, Sektori për Menaxhimin e Aseteve ka vazhduar me administrimin, evidentimin dhe përditësimin e pasurive komunale, si dhe me procedurat për trajtimin e pasurive jashtë përdorimit.

Përditësimi i të dhënave në SIMFK dhe krijimi i bazës së të dhënave

Një nga aktivitetet kryesore gjatë kësaj periudhe ka qenë përditësimi dhe përpunimi i të dhënave në sistemin SIMFK, ku janë sistemuar të dhënat për pasuritë sipas klasifikimit përkatës. Janë përfshirë edhe të dhënat e viteve paraprake, me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe përditësimit të regjistrave. Gjithashtu, është krijuar dhe përditësuar baza e të dhënave në Excel, e cila shërben si arkiv digjital dhe mjet ndihmës për menaxhimin dhe raportimin e pasurive komunale.

Evidentimi dhe shitja e pasurive jashtë përdorimit

Gjatë periudhës janar–shtator 2026 është realizuar evidentimi i pasurive jo financiare jokapitale jashtë përdorimit në institucionet komunale, përfshirë shkollat, administratën komunale dhe QKMF-në. Procesi ka përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e pasurive që nuk janë më funksionale ose nuk janë në përdorim.

Në kuadër të këtij procesi është bërë edhe identifikimi i automjeteve komunale jashtë përdorimit dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse për shitjen e tyre.

Brenda periudhës nëntëmujore janë përfunduar procedurat për shitjen e të gjitha aseteve komunale të evidentuara jashtë përdorimit, përfshirë edhe automjetet. Me përfundimin e këtyre procedurave, Komuna e Rahovecit aktualisht nuk ka stok të aseteve të evidentuara jashtë përdorimit, duke përmbyllur procesin e trajtimit të pasurive të panevojshme të grumbulluara nga periudhat paraprake.

Sektori i Turizmit

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, Sektori i Turizmit, në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET), ka zhvilluar aktivitete me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit, me fokus të veçantë në turizmin e verës, agroturizmin, turizmin rural dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike.

Funksionalizimi i Zyrës së Turizmit

Gjatë kësaj periudhe është bërë funksionalizimi i Zyrës së Turizmit në Stacionin e Autobusëve në Rahovec, përmes rregullimit të hapësirës dhe bartjes së aseteve përkatëse. Zyra shërben si pikë informuese për vizitorët dhe turistët, si dhe për koordinimin e aktiviteteve promovuese në fushën e turizmit.

Investimet në infrastrukturën turistike dhe agroturistike

Ka filluar implementimi i projektit "Revitalizimi i hapësirave agroturistike dhe trajtimi i peizazhit rural", në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Projekti është duke u realizuar në zonën Hamoc–Fortesë dhe përfshin investimin në rrugë, ndriçim publik, rregullimin e hapësirave dhe elemente të tjera të infrastrukturës në funksion të zhvillimit të turizmit rural dhe agroturizmit. Përfundimi i punimeve pritet deri në fund të vitit 2026.

Kanë vazhduar gjithashtu punimet në projektin "Kroi i Demirit" në Drenoc, si dhe mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes dhe hapësirave me interes turistik.

Turizmi i verës dhe bashkëpunimi me prodhuesit vendorë

Fokus i veçantë gjatë nëntëmujorit i është kushtuar zhvillimit të turizmit të verës. Është mbajtur takim me rreth 10 prodhues të verës, ku është diskutuar për marketingun, promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit publiko-privat.

Bashkëpunimi me Shoqatën "Enologjia" ka vazhduar përmes takimeve me drejtuesit dhe prodhuesit e verës, ku është diskutuar për promovimin e verërave të Rahovecit, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe mundësitë për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e "Shtëpisë së Verës".

Në kuadër të projektit GROW, në bashkëpunim me Swisscontact, është duke u punuar në hartimin e Katalogut Kombëtar të Prodhuesve të Verës, ku Rahoveci përfaqësohet nga tetë prodhues të verës.

Festivali i Vjeljes së Rrushit – Hardh Fest 2026

Drejtoria ka kontribuar në organizimin e Hardh Fest 2026, përfshirë implementimin e QR Code për paraqitjen e ankesave dhe vërejtjeve gjatë festivalit. Gjithashtu, është propozuar që në edicionet e ardhshme festivali të ketë fokus edhe më të madh në promovimin e verës, kantinave dhe prodhuesve vendorë, përfshirë propozimin që të mos lejohet shitja e birrës, me qëllim të fuqizimit të identitetit të tij si Festë e Vjeljes së Rrushit.

Aktivitetet gjatë Muajit të Mërgatës

Gjatë muajve korrik dhe gusht, në kuadër të Muajit të Mërgatës, janë organizuar mbrëmje muzikore dhe aktivitete në qytet në bashkëpunim me lokalet dhe bizneset vendore. Aktivitetet kanë kontribuar në gjallërimin e qytetit gjatë sezonit veror dhe në mbështetjen e gastronomisë dhe ekonomisë lokale.

Vizitat dhe promovimi ndërkombëtar

Rahoveci ka qenë nikoqir i rreth 200 studentëve nga 40 vende të ndryshme të botës, të cilët kanë vizituar kantinat e verës, vreshtat dhe lokalet agroturistike, duke u njohur me traditën e kultivimit të rrushit, prodhimit të verës dhe ofertën turistike të komunës.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar edhe vizita të turistëve dhe grupeve të ndryshme ndërkombëtare, duke kontribuar në promovimin e Rahovecit si destinacion i turizmit të verës dhe agroturizmit.

Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar

Janë zhvilluar kontakte dhe bashkëpunime me institucione qendrore, organizata vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë UNDP, KIESA, Caritas Kosova dhe Swisscontact, me fokus në turizëm, agroturizëm, zhvillim rural dhe promovimin e potencialeve të Rahovecit.

Gjithashtu, është realizuar një takim virtual me përfaqësues të turizmit nga Burundi, ku janë shkëmbyer përvoja lidhur me zhvillimin e turizmit dhe potencialin e Rahovecit në turizmin e verës.

Planifikimi dhe promovimi i turizmit

Gjatë kësaj periudhe është punuar në planifikimin e aktiviteteve dhe projekteve për zhvillimin dhe promovimin e turizmit, përgatitjen e materialeve promovuese dhe identifikimin e projekteve të reja në fushën e turizmit rural dhe agroturizmit.

Promovimi i verërave të Rahovecit në Berat

Në kuadër të aktivitetit "Wine & Stories of Berat" në Berat, Shqipëri, Rahoveci është përfaqësuar nga pesë kantina të verës, të cilat kanë fituar gjithsej nëntë çmime, duke promovuar cilësinë e verërave vendore dhe Rahovecin si destinacion të turizmit të verës.

Drejtor i DEZHT

Altin Zhuniqi